



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.37**

**2005**

**30 maj**

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9377 datë 21.4.2005	Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar .....	1343
Ligj nr.9378 datë 28.4.2005	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin që ndryshon nenet 1(A) dhe 14(1),(3)(B) të Marrëveshjes Europiane të 30 shtatorit 1957 për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), bërë në Gjenevë më 28 tetor 1993 .....	1352
Ligj nr.9381 datë 28.4.2005	Për kompensimin e burgimit të padrejtë .....	1354
Vendim i Kuvendit nr.185, datë 4.5.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.184, datë 28.4.2005 "Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për Taksën e Rrugës Durrës-Kukës" .....	1357
Vendim i KM nr.334, datë 20.5.2005	Për hapjen e pikës së kalimit kufitar në fshatin Borje të Kukësit, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën .....	1358

Vendim i KM nr.337, datë 20.5.2005	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të ish-kampingut për të ardhurat nga Kosova, në Sheq të Vogël, Fier, nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit te Ministria e Drejtësisë.....	1358
Vendim i KM nr.355, datë 20.5.2005	Për miratimin e kontratës me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe Shoqërive Occidental of Albania (ONSHORE-2) Limited dhe Occidental of Albania (ONSHORE-3) Limited, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, blloku 2 dhe 3 në tokë, Shqipëri....	1359
Udhëzim i KM nr.3, datë 13.5.2005	Për procedurat e miratimit të zonës informale.....	1359
Vendim i GJK nr.11, datë 18.5.2005	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.454, datë 27.2.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	1359
Vendim i KKRT nr.340, datë 20.5.2005	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Fokus”.....	1364
Vendim i KKRT nr.342, datë 20.5.2005	Mbi zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit radiofinik vendor privat “Radio 7”.....	1364
Vendim i KKRT nr.343, datë 20.5.2005	Mbi zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit radiofonik vendor privat “Energy”.....	1365
Vendim i KKRT nr.344, datë 20.5.2005	Për dhënie licence për radio vendore private “Club Alson”.....	1365
Vendim i KKRT nr.345, datë 20.5.2005	Për dhënie licence për radio vendore private “Armonia Fm”.....	1366
Vendim i KKRT nr.346, datë 20.5.2005	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “Armonia TV”.	1366
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogzhinë-Elbasan (Paper-Vidhas dhe Vidhas-Kombinati Metalurgjik).....	1367
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt shpronësimin publik të pasurive pronë e paluajtshme për objektin “Për ndërtimin e Qendrës Kombëtare Stërvitore Bazë (QKSB) të FA të RSH në rajonin Bunavi”.....	1372
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasës Liljana Sollaku .....	1374

**LIGJ**  
**Nr. 9377, datë 21.4.2005**

**PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË LIGJIN NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR  
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 4

Sigurimi shoqëror suplementar për personat që ushtrojnë funksione ose detyra të veçanta kushtetuese, për punonjësit e shtetit, për ushtarakët që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe ata të Shërbimit Informativ të Shtetit bëhet sipas kriterëve të përcaktuara me ligje të veçanta.

Organi i ngarkuar nga Këshilli i Ministrave ka të drejtë të autorizojë çdo person juridik për të dhënë pension suplementar në kushtet e përcaktuara me ligj të veçantë."

Neni 2

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7

**Mbrojtja për shtetasit shqiptarë jashtë shtetit dhe shtetasit e huaj**

Sigurimet shoqërore u japin mbrojtje edhe:

a) shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dypalëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

b) shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, që punojnë në Shqipëri."

Neni 3

Pika 1 e nenit 27 ndryshohet si më poshtë:

"1. E ardhura për barrë lindje i paguhet gruas së siguruar për barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ajo ka 12 muaj periudhë sigurimi, për çdo rast përfitimi. Përfshihet nga ky rregull rasti kur gjatë periudhës së përfitimit të barrë lindjes grua ka kushte për një përfitim të ri barrë lindjeje."

#### Neni 4

Në nenin 31 bëhen këto ndryshime:

a) titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:

"Pension pleqërie i plotë";

b) pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Personat e siguar kanë të drejtë për pension pleqërie të plotë në moshën 65 vjeç burrat dhe 60 vjeç gratë, pasi të kenë plotësuar 35 vjet sigurim. Për periudhën e tranzicionit bëhet përjashtim nga ky rregull dhe zbatohet neni 92 i dispozitave tranzitore të këtij ligji.".

#### Neni 5

Në fund të pikës 4 të nenit 32 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Paga neto mesatare e 3 viteve të njëpasnjëshme të 10 viteve të fundit të punës së personit të siguar indeksohet çdo vit, sipas rregullave të indeksimit të bazës së vlerësuar.".

#### Neni 6

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 33

I siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie të plotë, sipas neneve 31 e 92 të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,34 për qind të pensionit të plotë, për çdo muaj që vazhdon të punojë dhe që paguan kontribute.

Përfituesi i pensionit të plotë të pleqërisë, që ndërpret pensionin, vazhdon të punojë dhe paguan kontribute, merr shtesë mbi pension në masën 0,34 për qind për çdo muaj ndërprerjeje. Kjo shtesë llogaritet mbi atë masë pensioni që rezulton pas rritjeve dhe indeksimit që ka pësuar pensioni gjatë kohës së ndërprerjes.".

#### Neni 7

Në pikën 1 të nenit 34 fjalët "më shumë se 20 vjet" zëvendësohen me fjalët "më shumë se 15 vjet".

#### Neni 8

Në nenin 35 bëhen këto ndryshime:

a) në paragrafin e parë të pikës 1 hiqen fjalët "gjatë kohës që është i siguar";

b) pika 2 ndryshohet si më poshtë:

" 2. Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa gjysma e diferencës së moshës së personit të siguar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç.

Personi, që është në kushtet e invaliditetit të plotë, por që nuk plotëson periudhën minimale të sigurimit, ka të drejtë për pension invaliditeti të reduktuar, në masën që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.".

#### Neni 9

Në fund të pikës 4 të nenit 36 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Paga mesatare neto e vitit të fundit indeksohet çdo vit, sipas rregullave të indeksimit të bazës së vlerësuar.".

## Neni 10

Pas nenit 37 shtohet neni 37/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 37/1

### **Pension invaliditeti i reduktuar**

Masa e pensionit të invaliditetit të reduktuar llogaritet duke shumëzuar masën e llogaritur të invaliditetit të plotë me koeficientin që rezulton nga raporti i periudhës së tij të sigurimit me periudhën e duhur për pension të plotë invaliditeti.''.

## Neni 11

Neni 39 ndryshohet si më poshtë:

“Një person i siguruar i paaftë, që merr pension invaliditeti sipas nenit 35 dhe që ka në ngarkim fëmijët deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në 25 vjeç, merr një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 për qind.”.

## Neni 12

Pika 1 e nenit 40 ndryshohet si më poshtë:

"1. Personat, që janë në ngarkim të personit që vdes, i cili kishte kushte për përfitimin e njërit nga llojet e pensioneve ose merrte pension, kanë të drejtë të marrin pension familjar.”.

## Neni 13

Neni 44 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 44

### **Aksidenti në punë dhe sëmundjet profesionale**

Aksidenti në punë ose për shkak të punës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Sëmundjet profesionale përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë.”.

## Neni 14

Në nenin 48 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Personi që përfiton të ardhura, sipas paragrafit të parë të këtij neni dhe:

- ka nevojë për një kujdesje të vazhdueshme nga një person tjetër, sipas vendimit të Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP), i jepet një pagesë shtesë prej 15 për qind të bazës së vlerësueshme;

- ka në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë apo janë të paaftë për punë deri në moshën 25 vjeç, përfitojnë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 për qind.”.

## Neni 15

Në pikën 1 të nenit 53 bëhen këto ndryshime:

a) në shkronjën "a", pas fjalëve "jo më pak se 12 muaj" shtohen fjalët "për çdo rast përfitimi”;

- b) shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:  
"b) janë vërtetuar nga zyra përkatëse e punës se:  
- janë punëkërkues të papunë, të gatshëm të punësohen, kur u ofrohet një punë e paguar, e përshtatshme;  
- pranojnë të kualifikohen ose të rikualifikohen."

#### Neni 16

Pika 3 e nenit 24 ndryshohet si më poshtë:  
"3. Përfituesit që kanë në ngarkim fëmijë deri në moshën 18 vjeç ose kur këta studiojnë ose janë të paafte për punë deri në 25 vjeç, përfitojnë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 për qind të të ardhurave nga papunësia, por jo më shumë se 30 për qind. Kur njëri nga prindërit është në marrëdhënie pune ose merr pension të plotë, shtesa reduktohet në masën 50 për qind."

#### Neni 17

Pika 1 e nenit 55 ndryshohet si më poshtë:  
"1. E ardhura e papunësisë paguhet deri në 12 muaj, sipas përcaktimit të vendimit të Këshillit të Ministrave."

#### Neni 18

Në nenin 59 bëhen këto ndryshime:  
a) titulli i nenit ndryshohet si më poshtë:  
"Baza e vlerësuar për llogaritjen e përfitimeve";  
b) pika 1 riformulohet si më poshtë:  
"1. Baza e vlerësueshme për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi.  
Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 e në vazhdim, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merret shuma e pagave, për të cilat janë paguar kontributet nga data 1.1.1994 deri në fund të periudhës së sigurimit.  
Për periudhën e sigurimit para datës 1.1.1994, për llogaritjen e bazës së vlerësuar, merren pagat referuese, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.  
Në rastet kur personi i siguruar ka periudhë sigurimi para dhe pas datës 1.1.1994, baza e vlerësuar llogaritet si mesatare aritmetike e ponderuar e bazës së vlerësuar të të dyja periudhave.";  
c) pika 3 riformulohet si më poshtë:  
"3. Çdo vit, duke filluar nga data 1 janar, baza e vlerësuar vjetore individuale indekskohet me koeficientin, që llogaritet si raport i kontributit mesatar për çdo person të siguruar, të mbledhur në vitin e fundit kalendarik, kundrejt të njëjtit tregues të vitit pararendës. Ky koeficient caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.";  
ç) pika 5 riformulohet si më poshtë:  
"5. Pensionet e invaliditetit nuk do të llogariten me një bazë të vlerësuar më të ulët se ajo e paguar më parë. Sapo të jetë përfituar një pension invaliditeti, shuma e pensionit do të merret si kufi minimal, kur llogaritet çdo pension tjetër sipas ligjit të sigurimeve shoqërore."

#### Neni 19

Në nenin 60, pas falëve "që nuk kanë pagë" shtohen fjalët "ose që nuk kanë dokumentin, i cili vërteton pagën".

Neni 20

Neni 61 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 61

Pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare indeksohen çdo vit, për të kompensuar pasojat e ndryshimit të çmimeve të mallrave dhe të shërbimeve të zgjedhura për nivelin minimal të jetesës së pensionistëve. Këshilli i Ministrave cakton listën e mallrave të zgjedhura, mbi të cilën llogaritet indeksi, metodën e llogaritjes dhe datën e indeksimit."

Neni 21

Në nenin 62 bëhen këto shtesa:

a) në fund të pikës 1 shtohet fjalia "kjo e drejtë mund të ushtrohet jo më shumë se tri herë.'";

b) në pikën 3 bëhen këto shtesa:

i) në paragrafin e tretë, pas fjalëve "por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit" shtohen fjalët "dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e kështit mujor të pensionit";

ii) në paragrafin e katërt, pas fjalëve "detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër" shtohen fjalët "dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e kështit mujor të pensionit".

Neni 22

Pas nenit 62 shtohet neni 62/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 62/1

**E drejta për informim**

Personi i siguruar ka të drejtë të informohet për kontributet dhe/ose përfitimet nga sigurimet shoqërore. Procedura dhe periudhat për informim caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 23

Pika 3 e nenit 67 ndryshohet si më poshtë:

"3. Për shpenzime administrative në buxhetin e sigurimeve shoqërore planifikohet një shumë deri në 5 për qind të shpenzimeve totale."

Neni 24

Paragrafi i dytë i pikës 2 të nenit 68 ndryshohet si më poshtë:

"Transferimi dhe përdorimi i fondeve bëhen vetëm sipas këtij ligji dhe rregullave të caktuara në Statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore."

Neni 25

Neni 69 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 69

Shteti garanton fondin e sigurimeve shoqërore të detyrueshme në rast falimentimi. Këshilli i Ministrave ka të drejtën e mbikëqyrjes së financimit për sigurimet shoqërore, të revizionimit të llogarive vjetore dhe të miratimit të buxhetit."

Neni 26

Pika 2 e nenit 71 ndryshohet si më poshtë:

" 2. Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohen me këtë ligji."

Neni 27

Neni 72 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 72

**Përbërja dhe emërimi i Këshillit Administrativ**

1. Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore përbëhet nga 12 anëtarë, nga të cilët:

a) 6 anëtarë të ndarë si më poshtë:

- i) një përfaqësues nga Ministria e Financave;
- ii) një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë;
- iii) një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale;
- iv) një përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë;
- v) një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë;
- vi) një përfaqësues nga Instituti i Statistikave.

Funksionet e këtyre përfaqësuesve caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) 3 anëtarë caktohen nga organizatat më të përfaqësuara të punëdhënësve, të cilat përzgjidhen me vendim të Këshillit të Ministrave;

c) 3 anëtarë caktohen nga sindikatat më të përfaqësuara, të cilat përzgjidhen me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Emërimi i anëtarëve të përcaktuar në shkronjat "b" dhe "c" është i vlefshëm për një periudhë jo më shumë se 5 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

3. Shkarkimi i anëtarëve mund të bëhet në çdo çast nga autoriteti që i cakton."

Neni 28

Në pikën 1 të nenit 74 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

a) pas shkronjës "b" shtohet shkronja "b/1" me këtë përmbajtje:

"b/1) përcakton e miraton strukturën dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.";

b) shkronja "e" ndryshohet si më poshtë:

"e) miraton rregulloret e propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përgjegjësive që përcaktohen nga ligji e statuti dhe që kanë të bëjnë me çështje financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore."

Neni 29

Neni 75 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 75

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm**

Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së ka këto detyra e përgjegjësi:

- a) përfaqëson Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe drejton veprimtarinë e tij;
- b) miraton rregulloret e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për organizimin, administrimin dhe procedurat administrative, sipas ligjit;
- c) mbledh bordin e drejtuesve, si një organ këshillues pranë tij, ku bëjnë pjesë zëvendësdrejtorët e përgjithshëm dhe drejtorët e drejtorive rajonale;
- ç) përcakton rregullat e brendshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- d) emëron punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, drejtorët e drejtorive rajonale, si dhe përcakton rregullat e rekrutimit të personelit për këto drejtori;
- dh) vendos për të gjitha çështjet e veprimtarisë së Institutit të Sigurimeve Shoqërore brenda kufijve të planit financiar dhe dispozitave ligjore në fuqi;
- e) përgjigjet për të gjitha çështjet e administrimit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe raporton para Këshillit Administrativ;
- ë) propozon në Këshillin Administrativ buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, planin financiar, paraqet raportin vjetor, parashikimin financiar 3-vjeçar, si dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për kontributet dhe problemet financiare."

Neni 30

Neni 76 shfuqizohet.

Neni 31

Në nenin 77 bëhen këto ndryshime:

- a) pika 3 shfuqizohet;
- b) pas pikës 2 shtohen pikat 3 e 4 me këtë përmbajtje:  
"3. Instituti i Sigurimeve Shoqërore raporton te Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale për realizimin e politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore, për realizimin e programit vjetor të zhvillimit të skemës së sigurimeve shoqërore, si dhe për probleme të tjera të ngarkuara nga Ministri.  
4. Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale mbikëqyr zbatimin e politikave të Qeverisë në fushën e sigurimeve shoqërore."

Neni 32

Neni 78 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 78

### **Statuti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore**

Këshilli i Ministrave miraton Statutin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili rregullon veprimtarinë e këtij institucioni dhe marrëdhëniet ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshillit Administrativ dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore."

Neni 33

Neni 83 ndryshohet si më poshtë:

### "Neni 83

Personeli mjekësor dhe anëtarët e komisionit mjekësor ose të KMCAPI-it, që gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre veprojnë në kundërshtim me normat e caktuara dhe cenojnë fondet e sigurimeve shoqërore, dënohen me gjobë në masën nga 3 deri në 5-fishin e pagës minimale, në shkallë vendi. Gjoha vendoset nga personeli i ISSH-së, përgjegjës për paaftësinë e përkohshme, barrë lindjen dhe ekspertizën mjekësore.

Kundër vendimit të gjobës bëhet ankimi, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, te Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së, i cili vendos lënien në fuqi, shfuqizimin ose ndryshimin e masës së gjobës."

### Neni 34

Në fund të pikës 3 të nenit 85 shtohen fjalët "brenda ditës së fundit të muajit të ardhshëm nga data e pranimit të kërkesës dhe të dokumenteve të plota e të sakta për pension."

### Neni 35

Neni 86 ndryshohet si më poshtë:

#### "Neni 86 Ankimimi

1. Ankimi kundër vendimeve të përfitimeve bëhet në komisionin e ankimit pranë drejtorive rajonale të sigurimeve shoqërore.

2. Ankimi kundër vendimeve të komisionit të ankimit pranë drejtorisë rajonale të sigurimeve shoqërore bëhet në komisionin e ankimit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Ankimet e zgjidhura në mënyrë të pafavorshme bëhen në gjykatë, vendimi i së cilës është përfundimtar.

4. Këshilli Administrativ përcakton përbërjen, numrin dhe procedurën e funksionimit të komisionit të ankimit pranë drejtorive rajonale dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore."

### Neni 36

Në nenin 88 bëhen këto ndryshime:

a) fjalia e fundit e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli i Ministrave bën indeksimin e pensioneve në atë masë dhe sa herë indeksohen pensionet e caktuara në bazë të ligjit.";

b) fjalia e fundit e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"Këshilli i Ministrave bën indeksimin e pensioneve në atë masë dhe sa herë indeksohen pensionet e caktuara në bazë të ligjit.";

c) pika 5 shfuqizohet;

ç) në pikën 7, pas fjalëve "pension të parakohshëm" shtohen fjalët "pension për vjetërsi shërbimi".

### Neni 37

Pika 4 e nenit 91 ndryshohet si më poshtë:

"4. Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shpëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 1 shtator 2000 e në vazhdim, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie.

Në kuptim të këtij neni, viti shkollor është me 12 muaj.

Në këtë rast kontributet përballohen nga Buxheti i Shtetit, në kohën kur merret vendim për caktimin e pensionit.''

#### Neni 38

Në nenin 95, tabela e vjetërsisë në punë për pension pleqërie të pjesshëm zëvendësohet me tabelën si më poshtë:

Vitet	Mosha për burrat	Vitet e sigurimit për burrat	Mosha për gratë	Vitet e sigurimit për gratë
1993	60	12v 6m	55	10v
1994	60	12v 6m	55	10v 6m
1995	60	13v	55	11v
1996	60	13v 6m	55	11v 6m
1997	60	14v	55	12v
1998	60	14v 6m	55	12v 6m
1999	60	15v	55	14v
2000	60	15v 6m	55	15v
2001	60	16v	55	16v
01.07.2002 - 30.06.2003	60v 6m	17v	55v 6m	17v
01.07.2003 - 30.06.2004	61v	18v 6m	56v	18v 6m
01.07.2004 - 30.06.2005	61v 6m	15 v	56v 6m	15 v
01.07.2005 - 30.06.2006	62v	15 v	57v	15 v
01.07.2006 - 30.06.2007	62v 6m	15 v	57v 6m	15 v
01.07.2007 - 30.06.2008	63v	15 v	58v	15 v
01.07.2008 - 30.06.2009	63v 6m	15 v	58v 6m	15 v
01.07.2009 - 30.06.2010	64v	15 v	59v	15 v
01.07.2010 - 30.06.2011	64v 6m	15 v	59v 6m	15 v
2011 e në vazhdim	65v	15 v	60v	15 v

#### Neni 39

Neni 96 ndryshohet si më poshtë:

#### "Neni 96

"Personat, që krahas periudhës së sigurimit në ish-kooperativat bujqësore, kanë dhe jo më pak se gjysmën e periudhës së sigurimit, që kërkohet në vitin përkatës, sipas nenit 92 të këtij ligji, në marrëdhënie pune me shtetin, përfitojnë pension pleqërie sipas dispozitave të këtij ligji, ndërsa pension invaliditeti e pension familjar përfitojnë kur kanë jo më pak se gjysmën e periudhës së sigurimit që parashikojnë, respektivisht, nenet 35 e 40 të këtij ligji.

Në rastet e tjera, pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë. Shuma bazë caktohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa shtesa, që u jepet këtyre personave, do të jetë 1 për qind për çdo vit sigurimi, duke filluar nga data 1.10.1993 e në vazhdim, shumëzuar me bazën mesatare të vlerësuar, që personat e siguruar kanë arritur nëpërmjet kontributeve.

Të vetëpunësuarëve në bujqësi, që plotësojnë kushtet për pension, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, mund t'u njihen periudhat e së kaluarës si periudha sigurimi kundrejt pagesës së kontributeve për vitet përkatëse, në atë masë që është caktuar nga Këshilli i Ministrave, por jo për periudhat para datës 1.10.1993.

Kushtet për pension janë ato të përcaktuara në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë".

Periudha e sigurimit, për të cilën është derdhur kontribut pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, njihet vjetërsi pune në marrëdhënie me shtetin, për efekt të zbatimit të këtij neni."

Neni 40

Këshilli i Ministrave, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, nxjerr aktet nënligjore në zbatim të neneve 8, 13, 17, 18, 20 dhe 27 të këtij ligji.

Neni 41

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4567, datë 6.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**

## **LIGJ**

**Nr. 9378, datë 28.4.2005**

### **PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN QË NDRYSHON NENET 1(A) DHE 14 (1), (3)(B) TË MARRËVESHJES EUROPIANE TË 30 SHTATORIT 1957 PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME (ADR), BËRË NË GJENEVË MË 28 TETOR 1993**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

## **KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin që ndryshon nenet 1(A) dhe 14 (1), (3)(B) të Marrëveshjes Europiane të 30 shtatorit 1957 për Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), bërë në Gjenevë më 28 tetor 1993.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4570, datë 12.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**

## **PROTOKOLL AMENDUES**

### **I MARRËVESHJES EUROPIANE TË 30 SHTATORIT 1957 NË LIDHJE ME TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË MALLRAVE TË RREZIKSHME (ADR) PËRKATËSISHT NENIN 1 (A), NENIN 14 (1) DHE NENIN 14 (3) (B)**

Palët e këtij protokollit,

*duke pasur* në konsideratë dispozitat e Marrëveshjes Europiane në lidhje me Transportin Ndërkombëtar Rrugor të Mallrave të Rrezikshme (ADR), bërë në Gjenevë më 30 shtator 1957 (këtej e tutje e quajtur “Marrëveshja”), në lidhje me termin e përcaktuar “mjet” në nenin 1 (a) dhe procedurën për amendimin e shtojcave të Marrëveshjes, veçanërisht dispozitën e nenit 14 (1) të Marrëveshjes;

*duke vënë* re se gjatë procedurës për amendimin e shtojcave Palët Kontraktuese të Marrëveshjes kanë hasur vështirësi në zbatimin, brenda kufijve kohorë, të parashikuar në nenin 14 (3) të Marrëveshjes, e masave të brendshme që kërkohen për hyrjen në fuqi të amendamenteve;

*duke vënë* re më tej pikëpamjet e grupit të punës mbi transportin e mallrave të rrezikshme të Komitetit të Transportit Tokësor të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Europën dhe propozimet nga Qeveritë e Austrisë dhe Francës për të amenduar Marrëveshjen, kanë rënë dakord si më poshtë:

#### **Neni 1**

##### **Amendamenti i nenit 1 (a) të Marrëveshjes**

Neni 1 (a) i Marrëveshjes do të amendohet për t’u lexuar si më poshtë:

“(a) Termi “mjet” nënkupton çdo automjet, përveç një mjete të varur nga ose nën urdhrat e Forcave të Armatosura të një Pale Kontraktuese, për përdorim në rrugë, i kompletuar ose i mangët, që ka të paktën katër rrota dhe një shpejtësi maksimale të projektuar që i tejkalon 25 km për orë, si dhe trajlerin e tij, me përjashtim të mjeteve të cilat udhëtojnë mbi hekurudha, traktorëve bujqësorë dhe pyjore dhe të gjitha makinerive të lëvizshme.”

#### **Neni 2**

##### **Amendamenti i nenit 14 (1) të Marrëveshjes**

Neni 14 paragrafi (1) i Marrëveshjes do të amendohet për t’u lexuar si më poshtë:

“1. Në mënyrë të pavarur nga procedura e rishikimit që parashikohet në nenin 13, çdo Palë Kontraktuese mund të propozojë një ose më shumë amendamente për shtojcat e kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim duhet të përcjellë tekstin të Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm, gjithashtu mund të propozojë amendamente për shtojcat e kësaj Marrëveshjeje me qëllim sigurimin e harmonizimit ndërmjet këtyre shtojcave dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, në lidhje me transportin e mallrave të rrezikshme.

Përveç kësaj, ai mund të propozojë amendamente të shtojcave të kësaj Marrëveshjeje, të cilat janë miratuar nga grupi i punës mbi transportin e mallrave të rrezikshme i Komitetit të Transportit Tokësor të Komisionit Ekonomik për Europën i Kombeve të Bashkuara, me kërkesë të grupit të punës.”

#### **Neni 3**

##### **Amendamenti i nenit 14 (3) të Marrëveshjes**

Neni 14 paragrafi (3) (b) i Marrëveshjes do të amendohet për t’u lexuar si më poshtë:

“(b) Pala Kontraktuese ose, sipas rastit, Sekretari i Përgjithshëm, duke paraqitur amendamentin e propozuar, në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, mund të specifikojë në propozim, me qëllim hyrjen në fuqi të amendamentit, nëse pranohet, një afat më të gjatë se tre muaj”.

Neni 4

**Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi**

1. Palët Kontraktuese në Marrëveshje mund të bëhen Palë Kontraktuese të këtij protokollit:
  - a) Duke e nënshkruar atë;
  - b) Duke e depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit ose miratimit në vijim të firmosjes subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi;
  - c) Duke depozituar instrumentin e pranimit.
2. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në zyrën e Sekretarit Ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, Gjenevë, nga 29 tetori 1993 deri në 31 janar 1994.

Neni 5

**Depozitimi**

Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 6

**Hyrja në fuqi**

Ky protokoll do të hyjë në fuqi një muaj mbas datës në të cilën të gjitha Palët Kontraktuese të Marrëveshjes e kanë nënshkruar atë pa rezerva ndaj ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit ose pasi kanë depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 7

Çdo shtet, i cili bëhet palë e Marrëveshjes pas përbushjes së kushteve të hyrjes në fuqi të këtij protokollit, në përputhje me nenin 6, do të konsiderohet si Palë Kontraktuese e Marrëveshjes siç amendohet nga protokollit.

Neni 8

Originali i këtij protokollit, tekstet anglisht dhe frëgjisht të të cilit janë njëlloj të vlefshme, do të depozitohen te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuar.

**LIGJ**

**Nr. 9381, datë 28.4.2005**

**PËR KOMPENSIMIN E BURGIMIT TË PADREJTË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1  
**Objekti i ligjit**

Ky ligj ka për objekt të rregullojë rastet e përfitimit dhe të kompensimit për burgim të padrejtë, përfshirë arrestin në shtëpi dhe masën e mënyrën e llogaritjes së tij, si dhe procedurat për kërkimin, pagesën dhe kompensimin për burgim të padrejtë.

Neni 2  
**E drejta e kompensimit**

Personi, që është deklaruar i pafajshëm ose për të cilin është pushuar çështja me vendim gjykate të formës së prerë apo të prokurorit, ose është mbajtur në burg tej kohës së caktuar në vendimin e dënimit, gëzon të drejtën e kompensimit për burgimin e vuajtur.

Neni 3  
**Rastet e burgimit të padrejtë**

Për efekt të këtij ligji, me burgim të padrejtë kuptohet:

- a) periudha e paraburgimit për një çështje ose akuzë, për të cilën prokuroria ka pushuar hetimet ose gjykata ka dhënë pafajësi ose ka pushuar çështjen;
- b) periudha e burgimit në zbatim të një vendimi, i cili, pas vënies në ekzekutim, është prishur dhe është dhënë pafajësi ose është pushuar çështja me vendim të formës së prerë;
- c) periudha e paraburgimit ose e burgimit më tepër nga sa është dënuar me vendim të formës së prerë;
- ç) periudha e paraburgimit kur, me vendim gjykate të formës së prerë, është vërtetuar se akti ishte nxjerrë pa respektuar kushtet e parashikuara në nenet 228 e 229 të Kodit të Procedurës Penale;
- d) periudha e paraburgimit tej kufijve ligjorë të afateve të lejuara për kohën e paraburgimit;
- dh) periudha e burgimit të padrejtë e shkaktuar nga gabimi në urdhrin e ekzekutimit të vendimit;
- e) periudha e vuajtjes së arrestit në shtëpi në rastet e përcaktuara në shkronjat “a”, “c”, “ç” dhe “d” të këtij neni.

Neni 4  
**Përrjashtimi nga e drejta e kompensimit**

1. Personi, që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë, ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar se vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.
2. Kur me vendim gjykate është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur para shfuqizimit.
3. E drejta e kompensimit nuk njihet për pjesën e periudhës së paraburgimit të vuajtur, që është llogaritur për efekt të caktimit të kohës së dënimit me burgim, në rastet e parashikuara në nenin 465 të Kodit të Procedurës Penale.
4. Personi i burgosur për një vepër, që ndiqet me ankim, përjashtohet nga përfitimi, kur çështja pushohet për shkak pajtimi.

Neni 5  
**Masa e kompensimit për burgim të padrejtë**

1. Kompensimi për burgim të padrejtë caktohet nga gjykata, duke mbajtur parasysh:

- a) të ardhurat nga paga për të punësuarit në sektorin publik ose në sektorin privat, deri një muaj para burgimit;
  - b) fitimin e realizuar nga veprimtaritë tregtare dhe fitimprurëse gjatë tri viteve të fundit para burgimit;
  - c) pensionet e përfituara para ose gjatë paraburgimit;
  - ç) pagën minimale në shkallë vendi për ata që kanë qenë pa punë, të paktën një muaj para datës së burgimit;
  - d) rrethana të tjera, të lidhura me gjendjen ekonomike e familjare të të burgosurit;
  - dh) të ardhurat nga puna në burg.
2. Kompensimi caktohet deri në 2 000 (dy mijë) lekë për një ditë burgim dhe 3 000 (tre mijë) lekë për një ditë paraburgim.

#### Neni 6

##### **Kompensimi për arrestin në shtëpi**

Periudha e arrestit në shtëpi kompensohet nisur nga të njëjtat kritere sikurse burgimi, por masa e kompensimit të caktuar nuk duhet të jetë më e madhe se një e dyta e shumës së caktuar për burgimin.

#### Neni 7

##### **Rikthimi në punë ose në detyrë**

Personi, që ka vuajtur paraburgimin ose arrestin në shtëpi dhe për këtë shkak është larguar nga puna ose nga detyra që kishte përpara vendosjes së këtyre masave, ka të drejtën e rikthimit në punë apo në detyrë, kur është vendosur pushimi i çështjes ose është dhënë pafajësi në favor të tij, sepse nuk ka kryer veprën që akuzohet, fakti nuk ekziston, fakti nuk përbën veprë penale ose fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

#### Neni 8

##### **Kërkesa për kompensim**

- 1 . Kërkesa për kompensim bëhet nga personi, që e përfiton atë sipas këtij ligji ose, pas vdekjes së tij, nga trashëgimtarët, përveç kur e drejta ka qenë parashkruar në kohën kur i burgosuri ishte gjallë.
2. Për personin e mitur ose të paaftë mendërisht këtë të drejtë e ushtron kujdestari ligjor.
3. Kërkesa për kompensim paraqitet brenda tri vjetëve nga data e lindjes së të drejtës në gjykatën e rrethit gjyqësor, që ka dhënë vendimin e dënimit, ose në territorin e së cilës ndodhet organi, që është ngarkuar, sipas këtij ligji, për pagesën e kompensimit për burgim të padrejtë.
4. Shqyrtimi gjyqësor bëhet sipas rregullave të gjykimit të padisë civile në procesin penal.
5. Ekzekutimi i vendimit gjyqësor për dhënien e kompensimit pezullohet kur rifillojnë hetimet e pushuara ose priset vendimi i pafajësisë apo pushimit të çështjes dhe përfituesi rimerret në përgjegjësi penale në të njëjtën çështje, edhe për të njëjtën veprë.
6. Kompensimet e përfituara kthehen, tërësisht ose pjesërisht, kur urdhërohet me vendim gjyqësor të formës së prerë.

#### Neni 9

##### **Pagesa e kompensimit për burgim të padrejtë**

1. Kompensimi për paraburgim dhe burgim të padrejtë përballohet nga Buxheti i Shtetit.

2. Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerrin udhëzime të përbashkëta për strukturat përgjegjëse, për formën dhe përmbajtjen e dokumentacionit, që paraqitet për ekzekutimin e pagesave të kompensimit për burgim të padrejtë.

Neni 10

Për të gjitha çështjet që janë në gjykim deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të zbatohen kriteret e deritanishme të rregulluara me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë.

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.4572, datë 12.5.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë  
Alfred Moisiu**

**VENDIM  
Nr. 185, datë 4.5.2005**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.184, DATË 4.5.2005 “PËR NGRITJEN E  
KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR PËR TAKSËN E RRUGËS DURRËS-KUKËS”**

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Në vendimin nr.184, datë 28.4.2005 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar për Taksën e Rrugës Durrës-Kukës”, pas pikës III shtohet pika III/a me këtë përmbajtje:  
“III/a. Përbërja e Komisionit është si më poshtë:

- |                  |                   |
|------------------|-------------------|
| 1. Preç Zogaj    | - Kryetar         |
| 2. Lekë Çukaj    | - Zëvendëskryetar |
| 3. Gjergj Koja   | - anëtar          |
| 4. Taulant Dedja | - anëtar          |
| 5. Albert Çaçi   | - anëtar          |
| 6. Nezir Selimi  | - anëtar          |
| 7. Jemin Gjana   | - anëtar          |
| 8. Fatos Beja    | - anëtar          |
| 9. Eqerem Spahia | - anëtar.”        |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI  
Servet Pëllumbi**

**VENDIM**  
**Nr. 334, datë 20.5.2005**

**PËR HAPJEN E PIKËS SË KALIMIT KUFITAR NË FSHATIN BORJE TË KUKËSIT, NË KUFIRIN SHTETËROR TOKËSOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME KOSOVËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 3 të nenit 24 të ligjit nr.8772, datë 19.4.2001 “Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Rendit Publik, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen e pikës së kalimit kufitar, në kufirin shtetëror tokësor të Republikës së Shqipërisë me Kosovën, në fshatin Borje të Kukësit, për komunikim ndërkombëtar.
2. Ngarkohen Ministria e Rendit Publik dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**VENDIM**  
**Nr. 337, datë 20.5.2005**

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË MJEDISEVE TË ISH-KAMPINGUT PËR TË ARDHURIT NGA KOSOVA, NË SHEQ TË VOGËL, FIER, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË DHE E USHQIMIT TE MINISTRIA E DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c”, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mjediset e objektit “Ish-kampingu për të ardhurit nga Kosova, Sheq i Vogël, Fier”, me sipërfaqe 10.5 ha, me numër kadastral a-1, të kalojnë në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit te Ministria e Drejtësisë, për t’u përdorur për sistemin e paraburgimit.
2. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë, Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**VENDIM**  
**Nr. 355, datë 20.5.2005**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS ME NDARJE PRODHIMI, NDËRMJET MINISTRISË  
SË INDUSTRIKËS DHE TË ENERGJETIKËS DHE SHOQËRIVE OCCIDENTAL OF  
ALBANIA (ONSHORE-2) LIMITED DHE OCCIDENTAL OF ALBANIA (ONSHORE-3)  
LIMITED, PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE,  
BLOKU 2 DHE 3 NË TOKË, SHQIPËRI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e kontratës, me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërive Occidental of Albania (Onshore-2) Limited dhe Occidental of Albania (Onshore-3) Limited, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, blloku 2 dhe 3 në tokë, Shqipëri, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**UDHËZIM**  
**Nr. 3, datë 13.5.2005**

**PËR PROCEDURAT E MIRATIMIT TË ZONËS INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 13 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

1. Evidentimi i sipërfaqeve të zëna me ndërtime banesash pa leje të kryhet në përputhje me procedurat e mëposhtme:

a) grupimin e formularëve “Vetëdeklarim për legalizim”, sipas vendndodhjes së ndërtimeve të banesave pa leje;

b) verifikimin në terren të ndërtimeve të banesave pa leje.

2. Përcaktimi i kufijve të zonës informale në terren dhe pasqyrimi i kufirit në hartë të bëhen në bazë të kritereve urbanistike të përcaktimit të zonës informale.

3. Propozimi i zonës informale të evidentuar për t’u përfshirë në procesin e legalizimit dhe të urbanizimit të paraqitet i shoqëruar me detyrën e projektimit.

4. Detyra e projektimit të zonës informale, që propozohet, duhet të përmbajë:

a) përshkrimin e zonës informale, ku të paraqiten:

- numri i përgjithshëm i ndërtimeve;

- numri i ndërtimeve të banesave pa leje, të deklaruara;

- numri i ndërtimeve të përfunduara;

- numri i ndërtimeve të papërfunduara (si karabina, themele etj.);

- ndarja e totalit të ndërtimeve, sipas funksionit dhe numrit të kateve;

b) numrin e banorëve, të ndarë në grupmosha;

c) studimet urbanistike të zonës, nëse ka, të miratuara në çdo nivel vendimmarrjeje;  
ç) propozimin për zhvillimin e ardhshëm të kësaj zone, si zonë e re banimi, të konfirmuar edhe nga këshilli i zgjedhur sipas përcaktimeve të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”;

d) mundësinë e integritit të kësaj zone në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të qendrës më të afërt të banimit, duke iu referuar largësisë nga vija kufizuese e ndërtimit (vija e verdhë);

dh) lidhjen me kufirin e brezit mbrojtës të zonave të mbrojtura nga aktet, ligjore dhe nënligjore, në fuqi, në rastet kur zona informale shtrihet në kufi me të;

e) relacionin përshkrues të problematikave kryesore gjeologo-inxhinierike të zonës;

ë) pasqyrën përmbledhëse të formularëve “Vetëdeklarim për legalizim”;

f) hartën në shkallën 1:1000 deri 1:2500, sipas madhësisë së zonës, ku të paraqitet zona e përditësuar me infrastrukturën inxhinierike mbi dhe nëntokësore dhe kufiri i propozuar i zonës;

g) hartën në shkallën 1:2500 deri 1:25 000, ku të paraqitet kufiri administrativo-territorial i njësisë së qeverisjes vendore dhe zona në lidhje me vijën kufizuese të ndërtimit të qendrës së banuar më të afërt;

gj) hartën kadastrale të zonës, në shkallën 1:2500 deri 1:5000, ku të pasqyrohet gjendja e pronësisë mbi tokën;

h) hartën në shkallën 1:1000 deri 1:2500, ku të paraqitet boniteti i tokës së zonës.

5. Për pajisjen me hartën kadastrale të zonës, në shkallën 1:2500 deri 1:5000, si dhe për hartimin e relacionit për gjendjen e pronësisë së tokës, sipas përcaktimit të shkronjës “gj” të pikës 4 të këtij udhëzimi, njësia e qeverisjes vendore të bashkëpunojë me zyrën përkatëse të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

6. Për përcaktimin e bonitetit të tokës, të konfirmuar në hartën e shkallës 1:1000 deri 1:2500 të zonës, sipas përcaktimit të shkronjës h” të pikës 4 të këtij udhëzimi, të merret mendimi me shkrim nga drejtoria përkatëse e bujqësisë dhe e ushqimit.

7. Propozimi për miratimin e zonës informale të shqyrtohet në këshillin e rregullimit të territorit të njësisë së qeverisjes vendore përkatëse dhe pas miratimit nga ana e saj, të paraqitet për shqyrtim e miratim në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Për zonat që ndodhen jashtë vijave kufizuese të ndërtimit të fshatrave, ky propozim kalon për shqyrtim dhe miratim në Këshillin e Rregullimit të Territorit të qarkut përkatës.

8. Për zonat që ndodhen brenda kufirit administrativo-territorial të dy njësive të qeverisjes vendore fqinje dhe/ose kur kufiri ndarës administrativo-territorial është i paqartë, propozimi për miratimin e zonës informale të shqyrtohet në këshillin e rregullimit të territorit të qarkut dhe të paraqitet për miratim në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë rast, detyra e projektimit hartohet nën drejtimin e njësisë së urbanistikës së qarkut, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore fqinje, sipas përcaktimit të neneve 20, pika 1, shkronja “a” dhe 22 pika 2 të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

9. Për miratimin e zonës informale të veprohet si më poshtë vijon:

a) Njësia e qeverisjes vendore depoziton në sekretarinë teknike të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, sipas përcaktimit të shkronjës “b” të nenit 8 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”:

i) kërkesën e organit të qeverisjes vendore;

ii) detyrën e projektimit, të shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 4 të këtij udhëzimi;

iii) vendimet e këshillave të rregullimit të territoreve përkatëse;

iv) konfirmimin nga drejtoria përkatëse e bujqësisë dhe e ushqimit për bonitetin e tokës.

b) Në procesin e miratimit të zonës informale në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, Agjencia e Legalizimit dhe e Urbanizimit të Zonave Informale, pasi shqyrton materialin e përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike, të shprehet me shkrim pranë sekretarisë teknike të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

c) Pas miratimit në Këshillin e Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, njësia e qeverisjes vendore përkatëse të afishojë në vende publike hartën me kufirin e zonës informale, të

miratuar.

10. Për hartimin dhe miratimin e studimit urbanistik të zonës informale, njësia e qeverisjes vendore të veprojë sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, dhe në vendimin nr.722, datë 19.11.1998 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së urbanistikës”.

Studimi urbanistik i hartuar afishohet për 30 ditë në zonën përkatëse dhe shqyrtohet në këshillin e rregullimit të territorit përkatës, brenda 10 ditëve nga mbarimi i afatit të afishimit.

Vendimi i miratimit të studimit urbanistik të përmbajë:

- i) materialin hartografik;
- ii) rregulloren e zbatimit.

Studimi urbanistik i çdo zone shqyrtohet nga Agjencia e Legalizimit dhe e Urbanizimit të Zonave Informale dhe mendimi i saj i përcillet sekretarisë teknike të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Vendimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë për miratimin e studimit urbanistik të zonës informale bëhet publik dhe afishohet në zonën përkatëse nga njësia e qeverisjes vendore.

11. Për zona të veçanta dhe/ose në pamundësi financimi nga Buxheti i Shtetit, Agjencia e Legalizimit dhe e Urbanizimit të Zonave Informale bashkërendon punën me njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, për kryerjen e studimit urbanistik të zonës informale, në funksion të përcaktimit të shkronjës “e” të nenit 8 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”.

12. Me miratimin e studimit urbanistik të zonës së shpallur, njësia e qeverisjes vendore të fillojë, menjëherë, punën për lirim të hapësirave për funksione publike, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 9 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”.

13. Fillimi i legalizimeve për zonën informale përkatëse autorizohet nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

Autorizimi për lejimin e fillimit të legalizimeve të ndërtimeve të banesave pa leje në zonën informale përkatëse, është vendim i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, që lëshohet sipas procedurës së mëposhtme:

a) Njësia e qeverisjes vendore përkatëse bën njoftimin për lirim të hapësirave publike të përcaktuara në studimin urbanistik, të miratuara për zonën informale, tek Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale;

b) Agjencia e Legalizimit dhe e Urbanizimit të Zonave Informale, brenda 30 ditësh nga marrja e njoftimit nga njësia përkatëse e qeverisjes vendore, kontrollon zbatimin në terren të studimit urbanistik të zonës informale përkatëse;

c) Kur lirim i hapësirave publike përputhet me studimin urbanistik të zonës informale përkatëse, kjo Agjenci i kërkon Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e saj të radhës, autorizimin për fillimin e legalizimeve.

14. Vendimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, për lejimin e legalizimeve të publikohet dhe të afishohet në vende publike të zonës përkatëse.

Vendimi është miratimi përfundimtar i studimit urbanistik të zonës informale përkatëse, në funksion të përcaktimit të bërë në shkronjën “b” të nenit 7 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”.

Me publikimin e vendimit të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, për lejimin e legalizimeve, njësia e qeverisjes vendore fillon procedurat e pajisjes me lejen e legalizimit, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 9 të ligjit nr.9304, datë 28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Fatos Nano

**VENDIM**  
**Nr. 11, datë 18.5.2005**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 8.2.2005, 1.8.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.19 Akti që i përket:

**KËRKUES:** 1. RAM META, PETRIT KUKA etj., përfaqësuar nga avokat Abaz Brati me prokurë.

2. KOMUNA DAJT, përfaqësuar nga kryetari i saj, Besim Kuka.

**SUBJEKTE TË INTERESUARA:**

1. FARUK BOROVA etj., përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi, me prokurë.

2. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE PRANË KËSHILLIT TË QARKUT TIRANË, përfaqësuar nga Isuf Demirxhiu e Fardinand Mino, me autorizim.

3. KËSHILLI I QARKUT TIRANË, përfaqësuar nga Isuf Demirxhiu e Fardinand Mino, me autorizim.

4. KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TIRANË

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.454, datë 27.2.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit kanë pretenduar përpara Gjykatës Kushtetuese se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e zhvillimit të një procesi të parregullt ligjor. Ata kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e këtij vendimi si antikushtetues:

- Në Gjykatën e Lartë gjykimi i çështjes është zhvilluar pa dijeninë e kërkuesve, si dhe në mungesë të avokatit të tyre. Rekursi i paraqitur ndaj vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk u është komunikuar të paditurve-kundërpaditës.

- Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është shpallur në mungesë të komunës Dajt. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe rekursi nuk i është komunikuar komunës Dajt.

- Mungesa e komunikimit të rekursit u ka hequr mundësinë kërkuesve të ushtrojnë kundërekurs dhe të realizojnë parimin e së drejtës së mbrojtjes e të kontradiktoritetit në gjykim.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Sadushi, përfaqësuesit e kërkuesve, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

## VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr.1559, datë 18.5.1999 ka pranuar padinë duke njohur si pronarë të një trualli trashëgimtarët e Ymer e Adem Borovës, detyrimin e anës së paditur të lirojë truallin, si dhe rrëzimin e kundërpadisë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.11, datë 20.3.2001, ka vendosur rrëzimin e padisë dhe pranimin e kundërpadisë. Mbi bazën e rekursit të paraqitur nga paditësit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.454, datë 27.2.2003, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë duke pranuar padinë dhe rrëzuar kundërpadinë.

Kërkuesit, të cilët kanë qenë në pozitën procedurale të të paditurit-kundërpaditës në këtë proces, pretendojnë se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë pa pasur dijeni, si dhe në mungesë të avokatit të caktuar prej tyre, ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.

Pretendimi kryesor i kërkuesve që lidhet me padijeninë e palëve për zhvillimin e një procesi gjyqësor, për arsye të moskomunikimit të rekursit, është trajtuar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet e rëndësishme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Zhvillimi i procesit gjyqësor në mungesë të palës ndërgjyqëse është e lidhur ngushtësisht me cenimin e disa të drejtave të tjera kushtetuese, si dhe me vetë drejtësinë e procesit.

E drejta e shtetasve për t'u mbrojtur është një ndër këto të drejta, e përbën thelbin e konceptit që jurisprudenca kushtetuese ka krijuar për procesin e rregullt ligjor. E drejta për të qenë i pranishëm në gjykim është një pjesë përbërëse e së drejtës për t'u mbrojtur. Kjo e drejtë i ngarkon autoritetet me detyrat që të njoftojnë palët dhe mbrojtësit e tyre, në kohë të mjaftueshme, për datën dhe vendin e mbajtjes së procedurave gjyqësore, për të kërkuar praninë e tyre dhe për të mos i përjashtuar padrejtësisht nga gjykimi. "Kjo është një praktikë tashmë e njohur dhe e konsoliduar e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës do të ishte pa vlerë përshkrimi në detaje i garancive procedurale të palëve në proces, në rast se atyre nuk do t'u sigurohej ajo që në fakt bën të mundur respektimin e këtyre të drejtave dhe që është pjesëmarrja në gjykim."<sup>1</sup>

Garancitë që ofron Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në analizë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat lidhen me njoftimin e rekursit palëve, me respektimin e së drejtës për t'u dëgjuar në një proces kontradiktoriteti, kur janë vërejtur nga Gjykata Kushtetuese se janë shkelur, kanë sjellë cenimin e të gjithë procesit dhe shfuqizimin e vendimeve gjyqësore si antikushtetuese.

Nga shqyrtimi në procesin kushtetues i çështjes konkrete rezulton se gjykimi në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në mungesë të kërkuesve. Çështja në Gjykatën e Apelit Tiranë është zgjidhur në favor të tyre dhe mbi këtë bazë rekursi i paraqitur nga pala kundërshtare duhej t'u komunikohet, me qëllim realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese. Nga dosja gjyqësore nuk rezulton që kërkuesit dhe avokatët e tyre të jenë vënë në dijeni për rekursin e paraqitur nga subjektet e interesuara në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte vërtetohet se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë është zhvilluar pa pasur dijeni kërkuesit si dhe avokatët e tyre.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesit është e drejtë, për arsye se ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

## PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131 shkronja "f" dhe 134 pika 1 shkronja "g" të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

<sup>1</sup> Vendimi nr.109, datë 28.5.2002 i Gjykatës Kushtetuese; Përmbledhje e vendimeve, viti 2002, faqe 137.

**VENDOSI:**

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr.454, datë 27.2.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**VENDIM**

**Nr. 340, datë 20.5.2005**

**PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “FOKUS”  
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “FOKUS CABLE” SH.P.K.**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. T'i japë subjektit shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Maliqit, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Halil Lalaj**

**VENDIM**

**Nr. 342, datë 20.5.2005**

**MBI ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR  
PRIVAT “RADIO 7”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, vendimeve të KKRT-së, nr.54, datë 16.7.2001 dhe nr.253, datë 31.8.2004, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendim nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Media J-7” sh.p.k. për radion vendore private “Radio 7”, me nr.licence 032/FML, në prefekturën e Fierit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet Departamenti Teknik, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Juridik dhe i licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**VENDIM**  
**Nr. 343, datë 20.5.2005**

**MBI ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR**  
**PRIVAT “ENERGY”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të KKRT-së nr.200, datë 26.12.2003, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “NRG Multimedia” sh.p.k. për radion vendore private “Energy”, me nr.licence 051/FML, në rrethin e Elbasanit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet Departamenti Teknik, Departamenti Ekonomik dhe Departamenti Juridik dhe i Licencave për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**VENDIM**  
**Nr. 344, datë 20.5.2005**

**PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR RADIO VENDORE PRIVATE “CLUB ALSION”**  
**SUBJEKTIT: Z.VRANO BEJKOVA**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. T'i japë subjektit fizik z.Vrano Bejkova, me vendndodhje në qytetin e Elbasanit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Halil Lalaj**

#### **VENDIM**

**Nr. 345, datë 20.5.2005**

#### **PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR RADIO VENDORE PRIVATE "ARMONIA FM"**

**SUBJEKTIT: SHOQËRIA "DROPULL" sh.p.k.**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë" të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

#### **VENDOSI:**

1. T'i japë shoqërisë "Dropull" sh.p.k., licencë duke e autorizuar të funksionojë si operator vendor radio FM private, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastër.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona mbulimet, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Halil Lalaj**

#### **VENDIM**

**Nr. 346, datë 20.5.2005**

#### **PËR DHËNIE LICENCE**

**PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT "ARMONIA TV"**

**SUBJEKTIT: SHOQËRIA "DROPULL" sh.p.k.**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", rregullores "Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë" të miratuar me vendimin nr.176, datë 18.9.2003 të KKRT-së, si dhe të zonave e frekuencave të lira të shpallura publikisht në muajin mars, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

## VENDOSI:

1. T'i japë shoqërisë “Dropull” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 5 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastër.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

## SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit shpall kërkesën “Për shpronësimin e pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Elbasan (Paper Vidhas dhe Vidhas-Kombinati Metalurgjik)”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
 DREJTORIA JURIDIKE  
 Rrethi Elbasan  
 Komuna Paper  
 Fshati Vidhas

**Lista e Pronareve qe shpronsohen per efekt te ndertimit te segmentit rrugor Rrogozhine - Elbasan ( Paper - Vidhas ).**

Lloji I Pasurise Patundshme: Toka bujqesore, objekte dhe dru frutore nr.(1-20)

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Toka bujqesore		Objekte (proc.veresimi dhe verifikimi)		Dru frutore						Vlera totale leke	Shenime	
				SIP.m2	Lim2	Vlefte leke	Sip. m2	Cnimi Lim2	Vlefte leke	Hurma Ullim cope	Fig cope	Portok cope	Fid.rrus hi cope			Totali cope
1	Banush		Balla	120	800	96000			3		4		2	9	35000	Plotesim dokumentacioni
2	Naim	Hajdar	Capja	130	800	104000	120									104000 Plotesim dokumentacioni
3	Shyqyri		Capja	130	800	104000										104000 Plotesim dokumentacioni
4	Shahin	Hajdar	Capja	88	800	70400			1		1			3	13000	83400 Plotesim dokumentacioni
5	Tasim	Rifat	Meta	174	800	139200						10		10	35000	174200 Plotesim dokumentacioni
6	Ndricim	Rexhep	Haka				128									0
7	Naim	Rexhep	Haka	192	800	153600	117		7		3		20	30	110000	263600 Plotesim dokumentacioni
8	Reshit	Demir	Haka	312	800	249600	165									249600 Plotesim dokumentacioni
9	Sokrat	Hazbi	Haka	133	800	106400										106400 Plotesim dokumentacioni
10	Zaje	Jonuz	Haka	56	800	44800	165									44800 Plotesim dokumentacioni
11	Zeqir	Osman	Beqari				135									0
12	Hazis	Hazis	Kasa				84									0
13	Sherif	Hasan	Hasa				203									0
14	Arben	Latif	Cela				117									0
15	Hajdar	Dalip	Xhekoi				106		6	1	4	1	10	22	92000	92000 Plotesim dokumentacioni
16	Shefqet	Hasan	Hasa	155	800	124000	43									124000 Plotesim dokumentacioni
17	Zaje	Fejzulla Sabri	Sheganaku	290	800	232000	171									232000 Plotesim dokumentacioni

Ing. B. Capuni

Ing. G. Mamaj



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
 MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT  
 DREJTORIA JURIDIKE  
 Rrethi Elbasan  
 Komuna Bradashesh  
 Fshati Bradashesh

Lista e Pronareve qe shpronsohen per efekt te ndertimit te segmentit rrugor Rrogzhine - Elbasan ( Vidhas - Kombinatat Metalurgjik, km 1.5 )

Lloji i Pasurise Patundshme: Toke bujqesore, objekte dhe dru frutor nr.(1-33 )

Nr	Emri	Atesia	Mbiemri	Toke bujqesore			Objekte (proc.vleresimi dhe verifikimi)		Dru frutore						Vlera totale leke	Shenime	
				Sip. m2	Cmimi L/m2	Vlefte leke	Sip. m2	Vlefte leke	Hurma cope	Ullini cope	Fig cope	Portok cope	Fid.rrus hi cope	Totali cope			Vlefte leke
1	Arben	Xhafer	Lieshanaku	40	1000	40000	40									40000	Proces rregjistrimi
2	Hamza	Xhafer	Lieshanaku	1337	1000	1337000										1625000	Proces rregjistrimi
3	Ruzhdi	Kalem	Zavalina	122	1000	122000										402000	Proces rregjistrimi
4	Kadri	Banush	Salla	1155	1000	1155000	140									1343500	Proces rregjistrimi
5	Mustafa	Xhafer	Salla	308	1000	308000										308000	Proces rregjistrimi
6	Relat	Xhafer	Cela	160	1000	160000										160000	Proces rregjistrimi
7	Ismail	Isuf	Cela	800	1000	800000										800000	Proces rregjistrimi
8	Ali	Ismail	Cela	640	1000	640000										640000	Proces rregjistrimi
9	Ramazan	Jace	Korca	490	1000	490000	141 +										
10	Arben	Petrit	Korca	528	1000	528000	45(H)									632500	Proces rregjistrimi
11	Qerim	Ramaza	Mallozi	541	1000	541000										606000	Proces rregjistrimi
12	Jakov	Josif	Qosja	234	1000	234000										861000	Proces rregjistrimi
13	Riza	Ismail	Cela	1613	1000	1613000										234000	Proces rregjistrimi
14	Agim	Xhemal	Sejati	138	1000	138000										1613000	Proces rregjistrimi
15	Fadil	Mustafa	Cela	64	1000	64000										138000	Proces rregjistrimi
16	Met	Isuf	Hoxha	1706	1000	1706000										64000	Proces rregjistrimi
17	Sulejman	Avdi	Tufa	10	1000	10000										1708000	Proces rregjistrimi
	Kadri	Fadil	Cela													10000	Proces rregjistrimi

Ing. B. Capuni

Ing. G. Mamaj



## SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Mbrojtjes shpall kërkesën për shpronësim publik të pasurive pronë e paluajtshme për objektin “Për ndërtimin e Qendrës Kombëtare Stërvitore Bazë (QKSB) të FA të RSH në rajonin Bunavi”.

Subjekt i këtij shpronësimi është Ministria e Mbrojtjes (Drejtoria e Ekonomi-Privatizimit).

Me anë të këtij publikimi ne kërkojmë të vënë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në sipërfaqen që shpronësohet dhe masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Shpronësimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes, për personat sipas listës emërore të mëposhtme.

**Parashikimi për vlerësimin e pasurive pronë private që shpronësohen në fazën e dytë 2005, të cilët preken nga ngritja e Q.K.S.B të FA. në rajonin Bunavijë, Vlorë.**

Lloji i pasurisë së paluajtshme : Tokë bujqësore (Zona Kadatrale Nr. 131(6) - Bunavi

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.kadastral	Nr.aktit marrjes tokes ne pronesi	Sip.sipas aktit te marrjes tokes ne pronesi (M <sup>2</sup> )	Kat. Tokes	Nen uje Mbi uje	Çmimi per M <sup>2</sup> i tokes (Leke)	Vlera (Leke)
1	Shtet			106/17		900	III	Mbi uje	800	
2	Shtet			106/19		4000	III	Mbi uje	800	
3	Vangjel	Naqe	Dema	106/20		830	III	Mbi uje	800	664 000
4	Shtet			106/21		920	III	Mbi uje	800	
5	Vasillaq	Pavillo	Dema	106/22		2250	III	Mbi uje	800	1 800 000
6	Novruz	Sabri	Tahiri	113/7		2250	III	Mbi uje	800	1 800 000
7	Shtet			113/8		2050	III	Mbi uje	800	
8	Shtet			113/6		1750	III	Mbi uje	800	
9	Shtet			113/18		4750	III	Mbi uje	800	
						Shuma				Shuma
						<b>5 330 m<sup>2</sup></b>				<b>4 269 000 Leke</b>

**Parashikimi për vlerësimin e pasurive pronë private që shpronësohen në fazën e dytë 2005, të cilët preken nga ngritja e Q.K.S.B të FA. në rajonin Bunavijë, Vlorë.**

Lloji i pasurisë së paluajtëshme : Tokë bujqësore (Zona Kadatrate Nr. 1173) –Bestrove.

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr.kadastral	Nr.aktit marrjes tokes ne pronesi	Sip.sipas aktit te marrjes tokes ne pronesi (M <sup>2</sup> )	Kat. Tokes	Nen uje Mbi uje	Çmimi per M <sup>2</sup> i tokes (Leke)	Vlera (Leke)
1	Shtet			25/2		4100	V	Nen uje	700	
2	I pa identifikuar			29/2		3300	V	Nen uje	700	2 310 000
3	Shtet			29/3		500	V	Nen uje	700	
4	I pa identifikuar			29/4		2300	V	Nen uje	700	1 610 000
5	Shtet			29/5		1100	V	Nen uje	700	
6	I pa identifikuar			30/3		3000	IX	Nen uje	300	900 000
7	Todi	Miti	Kordha	42/29	18352	1000	V	Nen uje	700	700 000
8	Todi	Miti	Kordha	44/14	18352	100	V	Mbi uje	600	60 000
9	Vangjel	Ilia	Poçi	44/15	18211	390	V	Mbi uje	600	234 000
10	Llazi	Nasto	Koreta	44/16	18213	430	V	Mbi uje	600	258 000
11	Kozma	Xoxi	Qirjo	44/17	18207	1080	V	Mbi uje	600	648 000
12	Shtet			44/18		1250	V	Mbi uje	600	
13	Sotir	Kristo	Tereziu	44/19	18214	680	V	Mbi uje	600	408 000
14	Todi	Kristo	Tereziu	44/20	18215	1070	V	Mbi uje	600	642 00
15	Jani	Lio	Poçi	44/22	18219	1190	V	Mbi uje	600	714 000
16	Niko	Nasi	Kordha	44/23	18204	680	V	Mbi uje	600	408 000
17	Sokrat	Rrapo	Koreta	44/24	18229	1360	V	Mbi uje	600	816 000
18	Leonidha	Rrapo	Koreta	44/25	18209	680	V	Mbi uje	600	408 000
19	Shtet			44/26		1450	V	Mbi uje	600	
20	Niko	Koçi	Çipi	46/59	18445	850	V	Mbi uje	600	510 000
21	Jani	Koçi	Çipi	46/60	18446	680	V	Mbi uje	600	408 000

22	Mihal	Kristo	Tupa	46/50	18201	70	V	Mbi uje	600	42 000	
23	Marko	Kristo	Tupa	46/51	18222	400	V	Mbi uje	600	240 000	
24	Stavri	Koçi	Qirjo	46/52	18206	430	V	Mbi uje	600	250 000	
25	Thoma	Thimo	Koreta	46/53	18329	680	V	Mbi uje	600	408 000	
26	Ljuka	Koçi	Koreta	46/54	18205	1900	V	Mbi uje	600	1 140 000	
27	Andrea	Petro	Koreta	46/55	18224	680	V	Mbi uje	600	408 000	
28	Ligor	Tago	Kordha	46/65	18322	680	V	Mbi uje	600	408 000	
29	Shtet			46/56		960	V	Mbi uje	600		
30	Foni	Koci	Cipi	46/58	18218	850	V	Mbi uje	600	510 000	
31	Jani	Lio	Koreta	46/57	18318	680	V	Mbi uje	600	408 000	
32	Bani	Milo	Buqi	46/61	18326	1100	V	Mbi uje	600	660 000	
33	Pandi	Milo	Buqi	46/62	18324	850	V	Mbi uje	600	510 000	
34	Vasil	Miti	Kordha	46/63	18323	850	V	Mbi uje	600	510 000	
35	Ligor	Tago	Kordha	46/65	18322	680	V	Mbi uje	600	408 000	
36	Liazi	Miti	Kordha	46/66	18225	1190	V	Mbi uje	600	714 000	
37	Shtet			46/67		2000	V	Mbi uje	600		
38	Vangjel	Lio	Koci	56/1	18221	2240	VII	Mbi uje	500	1 120 000	
39	Thoma	Thimo	Kordha	56/2	18329	1000	VII	Mbi uje	500	500 000	
40	Thimi	Miti	Kordha	56/3	18328	960	VII	Mbi uje	500	480 000	
41	Marko	Kristo	Tupa	56/4	18222	1620	VII	Mbi uje	500	810 000	
42	Mihal	Kristo	Tupa	56/5	18201	160	VII	Mbi uje	500	80 000	
43	Stavri	Kristo	Tupa	56/6	18223	1350	VII	Mbi uje	500	675 000	
44	Shtet			56/7		1360	VII	Mbi uje	500		
							Shuma			Shuma	
								39 270 m <sup>2</sup>			21 315 000 Leke

## KËRKESË

Shtetësi Emiljano Selmanaj, kërkon shpalljen të zhdukur të shtetases Liljana Sollaku.

KËRKUESI  
Emiljano Selmanaj

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:  
Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".  
Tel: 042 555 63; 267 468

**Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:**

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR ( i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

**DOLI NGA SHTYPI:**

**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**  
**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004**

Doli nga shtypi më 30.5.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi: 150 lekë